E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

(a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

(b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

(c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: -----**[OE e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[OE e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Vend ndodhja	Sas ia	Njësia	Çmimi Lekë		Çmimi Euro	
1	SHËRBIME RUTINE				Njësi	Total	Njësi	Total
1.1	DDD Sherbim Rutine (sipas par. 2.2.1) ne ACS02	Korçë	9	Nderhyrje				
1.2	DDD Sherbim Rutine (sipas par. 2.2.1) ne ACS03	Fier	9	Nderhyrje				
1.3	DDD Sherbim Rutine (sipas par. 2.2.1) ne cdo ABV	Korçë Berat, Fier	81	Nderhyrje				
CMIMI TOTAL 1								
2	SHËRBIME ME THIRRJE (ON CALL)							
2.1.1	Shërbim me thirrje dezinfektim (Virusë dhe Baktere ne ambientet e brendshme	Fier	500	m²				
2.1.2	Shërbim me thirrje per Brejtesit	Fier	2	Nderhyrje				
2.1.3	Shërbim me thirrje per insektet, folete etj	Fier	2	Nderhyrje				
2.1.4	Shërbim me thirrje per kontrollin dhe asgjësimin e insekteve dhe artropodëve	Fier	2	Nderhyrje				
2.1.5	Sherbim me thirrje per kontrollin dhe largimi i zvarranikëve	Fier	2	Nderhyrje				
2.2.1	Shërbim me thirrje dezinfektim (Virusë dhe Baktere ne ambientet e brendshme	Berat - Corovode	500	m2				

2.2.2	Shërbim me thirrje per Brejtesit	Berat - Corovode	2	Nderhyrje				
2.2.3	Shërbim me thirrje per insektet, folete etj	Berat - Corovode	2	Nderhyrje				
2.2.4	Shërbim me thirrje per kontrollin dhe asgjësimin e insekteve dhe artropodëve	Berat - Corovode	2	Nderhyrje				
2.2.5	Shërbim me thirrje per kontrollin dhe largimi i zvarranikëve	Berat - Corovode	2	Nderhyrje				
2.3.1	Shërbim me thirrje dezinfektim (Viruse dhe Baktere ne ambientet e brendshme	Korçë	500	m ²				
2.3.2	Shërbim me thirrje per Brejtesit	Korçë	2	Nderhyrje				
2.3.3	Shërbim me thirrje per insektet, folete etj	Korçë	2	Nderhyrje				
2.3.4	Shërbim me thirrje per kontrollin dhe asgjësimin e insekteve dhe artropodëve	Korçë	2	Nderhyrje				
2.3.5	Shërbim me thirrje per kontrollin dhe largimi i zvarranikëve	Korçë	2	Nderhyrje				
CMIMI TOTAL 2								
ÇMIMI TOTAL PA TVSH (CMIMI TOTAL 1+CMIMI TOTAL 2)								
TVSH (%)								
ÇMIMI TOTAL ME TVSH								
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit: Nënshkrimi, vula								

Shenim:

- Bazuar në kërkesën e Klientit tonë TAP, Operatorët ekonomike kur te ofertojnë duhet te mbajnë në konsideratë se fondi për shërbimet rutinë nuk duhet të tejkalojë vlerën 13,223 Euro pa tvsh ose 1,281,573 leke pa tvsh, në rast të kundërt, operatori ekonomik do të skualifikohet.**
- Çmimet per njësi do të ofrohen në lekë dhe në euro për arsye se faturat tatimore do të lëshohen nga OE fitues në euro për shkak të detyrimeve kontraktuale midis AGS sh.a dhe Klientit tonë TAP. Ne rast mospërputhje te çmimit ne leke me ate ne euro do te prevaloje ai ne leke.**
- Operatori ekonomik duhet ti referohet kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës 30.10.2025.**

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se *[emri i ofertuesit të siguruar]* ka derdhur një depozitë pranë *[emri dhe adresa e bankës]* / është garantuar pranë *[emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit]* me një vlerë prej *[monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen të realizohen në cdo mini kontratë që lidhet bazuar në MK do të jenë sipas zërave të përfshirë në këto tabele dhe afati i kryerjes së tyre do të përcaktohet rast pas rasti sipas nevojave të AK.

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Vendndodhja	Sasia	Njësia
1	SHËRBIME RUTINE			
1.1	DDD Shërbim Rutine (sipas par. 2.2.1) në ACS02	Korçë	9	Nderhyrje
1.2	DDD Shërbim Rutine (sipas par. 2.2.1) në ACS03	Fier	9	Nderhyrje
1.3	DDD Shërbim Rutine (sipas par. 2.2.1) në cdo ABV	Korçë Berat, Fier	81	Nderhyrje
2	SHËRBIME ME THIRRJE (ON CALL)			
2.1.1	Shërbim me thirrje dezinfektim (Viruse dhe Baktere në ambientet e brendshme)	Fier	500	m ²
2.1.2	Shërbim me thirrje për Brejtesit	Fier	2	Nderhyrje
2.1.3	Shërbim me thirrje për insektet, foletë etj	Fier	2	Nderhyrje
2.1.4	Shërbim me thirrje për kontrollin dhe asgjësimin e insekteve dhe artropodëve	Fier	2	Nderhyrje
2.1.5	Shërbim me thirrje për kontrollin dhe largimi i zvarranikëve	Fier	2	Nderhyrje
2.2.1	Shërbim me thirrje dezinfektim (Viruse dhe Baktere në ambientet e brendshme)	Berat - Corovode	500	m ²
2.2.2	Shërbim me thirrje për Brejtesit	Berat - Corovode	2	Nderhyrje
2.2.3	Shërbim me thirrje për insektet, foletë etj	Berat - Corovode	2	Nderhyrje
2.2.4	Shërbim me thirrje për kontrollin dhe asgjësimin e insekteve dhe artropodëve	Berat - Corovode	2	Nderhyrje
2.2.5	Shërbim me thirrje për kontrollin dhe largimi i zvarranikëve	Berat - Corovode	2	Nderhyrje
2.3.1	Shërbim me thirrje dezinfektim (Viruse dhe Baktere në ambientet e brendshme)	Korçë	500	m ²
2.3.2	Shërbim me thirrje për Brejtesit	Korçë	2	Nderhyrje
2.3.3	Shërbim me thirrje për insektet, foletë etj	Korçë	2	Nderhyrje
2.3.4	Shërbim me thirrje për kontrollin dhe asgjësimin e insekteve dhe artropodëve	Korçë	2	Nderhyrje
2.3.5	Shërbim me thirrje për kontrollin dhe largimi i zvarranikëve	Korçë	2	Nderhyrje

Shtojca 8

TERMAT E REFERENCES

1. HYRJE

AGS është një Kontraktor për Mirëmbajtjen e Gazsjellësit, që operon në kuadër të Tregut Shqiptar të Gazit. Është një shoqëri e përbashkët e krijuar midis operatorit shqiptar të transmetimit të gazit **Albgaz** dhe operatorit italian **Snam**, përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) në territorin e Shqipërisë.

AGS është e angazhuar të operojë gazsjellësin në mënyrë të sigurt, duke mbrojtur njerëzit, mjedisin, komunitetet lokale dhe asetet e kompanisë. Ky angazhim realizohet duke ndjekur parimet QHSE dhe duke siguruar përputhshmëri të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe kërkesat rregullatore.

Duke marrë në konsideratë natyrën specifike të aktivitetit dhe të shërbimeve që ofron, **AGS** kërkon të lidhë një marrëveshje sipas ligjit shqiptar për ofrimin e **Shërbimeve të Dezinfektimit dhe të Kontrollit të Dëmtuesve** për Klientin e saj.

Kontrata do të jetë në fuqi deri në fund të dhjetorit 2026 (me një kohëzgjatje prej 13 muajsh). Operatori ekonomik fitues do të jetë përgjegjës për të siguruar që të gjitha dispozitat e kësaj Fushë Shërbimesh të zbatohen plotësisht nga personeli i tij i përfshirë në ekzekutimin e shërbimeve.

1.1. Akronime

ACS03	Stacioni i Kompresorëve në Shqipëri 03. Vendndodhje Fier.
ACS02	Stacioni i Kompresorëve (Matës) të Shqipërisë 02. Vendndodhje Bilisht.
AGI	Instalimi mbi Tokë.
ABV	Stacioni i Valvulave të Bllokimit në Shqipëri (ABV24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 and ALV32).
ALV	Stacioni i Valvulës së Daljes në Det të Shqipërisë.
HSE	Health, Safety and Environmental.
MOWO	Shëndeti, Siguria dhe Mjedisi.
OMC	Qendra e Operimit dhe Mirëmbajtjes.
PPE	Pajisjet Mbrojtëse Personale.
PTW	Leja për të punuar.
QA	Sigurimi i Cilësisë.
QC	Kontrolli i Cilësisë.
PPE	Pajisjet Mbrojtëse Personale.
ROW	E drejta e kalimit.

1.2 Perkufizime

Instalimet mbi toke (AGI)	Do te thote ABV, ALV, ACS02 and ACS03
Ambientet	Do te thote Tubacioni, Instalimet mbi toke, Client Warehouses.
Klient	Do te thote TAP
Company	Do te thote AGS
Contractor	Do te thote operatori ekonomik
ATEX	Explosive Atmosphere; Hazardous Area.

2. FUSHA E SHËRBIMIT

Kontraktori do të sigurojë të gjithë mbikëqyrjen, fuqinë punëtore, materialet dhe pajisjet e nevojshme për të vlerësuar, monitoruar dhe kryer shërbimet e menaxhimit të dëmtuesve për ambientet e Klientit të **AGSco** dhe zonat e jashtme të lidhura me to.

Metodat e kontrollit të dëmtuesve do të kenë prioritet qasjet jo-kimike (p.sh., kurthe, mbrojtje ndaj hyrjes së dëmtuesve, menaxhim i habitatit). Metodat kimike mund të aplikohen vetëm kur metodat jo-kimike rezultojnë joefektive, dhe gjithmonë me autorizim paraprak nga Kompania. Këto metoda duhet të jenë në përputhje me listën e kimikateve të miratuara nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, në përputhje me Ligjin nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide”, VKM nr. 487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide” dhe VKM nr. 553, datë 27.7.2016 “Për Komisionin e Autorizimit të Produkteve Biocide.”

2.1. Objektivat

Kontraktori duhet të hartojë dhe zbatojë strategji të përshtatshme për të parandaluar **zonat me rrezik infestimi (shumim masiv i dëmtuesve)** dhe për të kontrolluar me shpejtësi çdo paraqitje të mëposhtme. Kjo Kontratë është e strukturuar si një marrëveshje kuadër, dhe kërkesat individuale të shërbimit do t’i adresohen Kontraktorit(ëve) në përputhje me kërkesat operacionale të Klientit dhe Kompanisë:

- **Brejtësit**
- **Insektet dhe artropodët e tjerë:**
 - a. Insekte zvarritëse (buburreca, vemje, milingona, pleshta, tarta, etj.);
 - b. Insekte fluturuese (miza, mushkonja, grerëza, bletë, etj.);
 - c. Araknidet (merimanga, akrepa, etj.).
- **Zvarranikët:**
 - a. Nepërka;
 - b. Gjarpërinj helmues dhe jo-helmues, si dhe zvarranikë tipikë të mjedisit shqiptar;
 - c. Hardhuca dhe gekonë.
- **Rreziqet mikrobiologjike:** Masa kontrolli dhe parandalimi lidhur me bakteret dhe viruset e dëmshme.

2.2. Pershkrimi i Shërbimeve

Shërbimet e kërkuara ndahen në dy kategori të ndryshme:

- **Shërbime rutinë** (të cilat do të kryhen sipas planit vjetor të mirëmbajtjes së TAP-it dhe planit të brendshëm të AGSco).
- **Shërbime sipas thirrjes** (në rast se AGSco konstaton nevojën për ndërhyrje shtesë ose ndërhyrje për shkak të shfaqjes së zvarranikëve, brejtësve, etj.).

2.2.1 Shërbimet rutinë në asetet e TAP-it

Shërbimet rutinë do të kryhen në **ACS02**, **ACS03** dhe në secilin **ABV**, përafërsisht çdo 2 muaj, sipas planit të mirëmbajtjes së TAP-it. Shërbimet do të kërkojnë me urdhra pune specifike të lëshuara nga AGSco.

Për çdo ndërhyrje, Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme:

- **Monitorimi dhe Përgatitja e Ndërhyrjes:**
Përpara fillimit të çdo aktiviteti në terren, Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e një inspektimi me qëllim identifikimin e çdo shenje të mundshme të infestimit nga cilido prej agentëve infestues të listuar në paragrafin 2.1 të kësaj fushe shërbimi.
- **Dokumentacioni** **HSEQ:**
Përpara fillimit të çdo aktiviteti në terren, Kontraktori do të jetë përgjegjës për përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve, si p.sh., por jo vetëm:
 - Përgatitja e **Metodologjisë së Punës (MoS – Method of Statement)**, e cila duhet të përgatitet nga operatori ekonomik dhe të miratohet nga AGSco përpara fillimit të punimeve.

- Përgatitja e **kërkesës për Leje Pune**, e cila duhet të përgatitet nga operatori ekonomik dhe të miratohet nga AGSco përpara fillimit të punimeve.
- **Lista e produkteve dhe Fletët e të Dhënave të Sigurisë (SDS)** që Kontraktori propozon të përdoren për ekzekutimin e aktiviteteve.
- **Shërbimi i kontrollit të brejtësve, si në hapësirat e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme:**
 - Aktivitetet në terren do të kryhen në përputhje me specifikimet e Klientit të AGSco.
 - Metodën kryesore të kontrollit do të jenë **mbledhja (me kurthe ose kurthe me ngjitës)** dhe **përrjashtimi**.
 - Për të parandaluar rezistencën ndaj karremit dhe helmimin dytësor, karremet rodenticide do të përdoren vetëm kur metodat e kapjes dhe përrjashtimit nuk japin rezultat.
 - Nëse përdoren **kuti karremash (mouse boxes)** me rodenticide, ato duhet të vendosen në një distancë prej 6–8 m nga njëra-tjetra dhe në një numër të mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha zonat e çdo impianti.
 - Kutitë e kontrollit të brejtësve duhet të vendosen edhe **nën dysheme** në ndërtesat ku ndodhen kabuj elektrike, fibra optike, etj.
 - Çdo kuti kontrolli brejtësish duhet të shënohet në planin ose projektin e çdo stacioni. Ky projekt vihet në dispozicion të operatorit ekonomik nga Autoriteti Kontraktor. Pastaj, është detyrë e operatorit ekonomik që të shënojë secilën kuti në këtë projekt me numrin përkatës, për të garantuar gjurmueshmërinë e kutive pas çdo ndërhyrjeje.
 - Çdo kuti kontrolli brejtësish duhet të fiksohet në tokë për të qëndruar e qëndrueshme dhe për të mos u zhvendosur nga era ose kushtet atmosferike.
 - Nëse një kuti kontrolli zhvendoset nga era, është përgjegjësi e kontraktorit që ta rikthejë atë në pozicionin fillestar.
 - Çdo kuti kontrolli duhet të ketë një etiketë që tregon datën e fundit të ndërhyrjes dhe që përditësohet me datën aktuale pas çdo ndërhyrjeje. Etiketat duhet të jenë mjaftueshëm rezistente për t'i përballuar kushtet atmosferike.
- **Kontrolli dhe asgjësimi i insekteve dhe artropodëve (vetëm për ndërhyrjet e planifikuara gjatë periudhës mars–tetor):**
 - Aktivitetet do të kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit.
 - Duhet të shmanget përdorimi i insekticideve spërkatëse, përveç sapunëve insekticidë dhe produkteve me bazë bimore (p.sh. vaj menteje, piretrina, vaj rozmarine, etj.).
 - Përdorimi i pesticideve të tjera duhet të autorizohet nga Kompania dhe, në çdo rast, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.
 - Llambat për kontrollin e mizave me letër ngjitëse, për eliminimin e insekteve fluturuese, si dhe përdorimi i tymit për dëmtuesit e drurit, do të duhet të miratohen paraprakisht nga Kompania
- **Kontrolli dhe largimi i zvarranikëve (vetëm për ndërhyrjet e planifikuara gjatë periudhës mars–tetor):**
 - Strategjitë parandaluese si repelentët e përputhshëm me mjedisin (repelentë me bazë vajrash esencialë) ose kimikatet e autorizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të zbatohen.
 - Në **ACS03/ACS02** dhe në çdo **ABV**, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë zonave pranë ndërtesave administrative dhe ndërtesave të tjera. Në këto zona, masat parandaluese duhet të garantojnë që gjarpërinjtë të mos afrohen pranë ose brenda ndërtesave.
 - Për të parandaluar hyrjen e zvarranikëve në zona specifike të ndërtesave ku nuk mund të përdoren kimikate, do të vendosen kurthe ngjitëse të posaçme për kapjen e zvarranikëve.
 - Largimi fizik duhet të kryhet sipas standardeve më të larta dhe në përputhje me ligjet për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë.
 - Për largimin e zvarranikëve do të përdoret pajisje e veçantë personale mbrojtëse e dedikuar posaçërisht për këtë lloj aktiviteti.
- **Raportimi**

Për çdo ndërhyrje të kryer, Kontraktori do të përgatisë një raport të detajuar me prova të aktiviteteve të realizuara. Në veçanti, Kontraktori duhet të përgatisë:

 - Një raport për çdo ndërhyrje të kryer në secilin **ABV**.

- Një raport për çdo ndërhyrje të kryer në **ACS02**, me shpjegim të detajuar të aktiviteteve të kryera në çdo zonë të stacionit.
- Një raport për çdo ndërhyrje të kryer në **ACS03**, me shpjegim të detajuar të aktiviteteve të kryera në çdo zonë të stacionit.
- Për të gjitha ndërhyrjet, Kontraktori do të lëshojë një **Certifikatë** ose dokument tjetër përkatës të shërbimeve **DDD**, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.
- **Kërkesën për pagesë**, sipas kontratës, për ndërhyrjet e kryera gjatë muajit në lidhje me raportet e përgatitura.
- Të gjitha produktet **DDD** duhet të shoqërohen me **certifikatë CE** ose ekuivalente, si dhe me dokumentacionin **MSDS**.

Të gjitha shërbimet përfshijnë mjetet, materialet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për të garantuar efektivitetin e trajtimit (p.sh., karremat, kutitë e brejtësve, produktet, llambat për kontrollin e mizave, etj.).

2.2.2 Shërbimet me thirrje

Përveç shërbimeve rutinë, **AGSco** mund t'i kërkojë Kontraktorit kryerjen e shërbimeve shtesë si më poshtë:

- Dezinfektim sipas thirrjes
- Kontroll i brejtësve sipas thirrjes
- Kontroll dhe/ose largim i zvarranikëve sipas thirrjes
- Trajtim ose heqje e folesë së insekteve fluturuese sipas thirrjes
- Trajtim dhe heqje e folesë së insekteve zvarritëse dhe artropodëve sipas thirrjes
- Aktivitete të tjera specifike të lidhura me fushën e kontratës

Çdo shërbim do të kërkohet me një urdhër pune specifik të lëshuar nga **AGSco**. Për çdo ndërhyrje, Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme:

- **Monitorimi:** Përpara fillimit të çdo aktiviteti në terren, Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e një inspektimi me qëllim identifikimin e çdo shenje të mundshme të **infestimit (shumim masiv i dëmtuesve)** nga cilido prej agentëve të listuar në paragrafin 2.1 të kësaj fushe shërbimi.
- **Propozimi:**
 - Dorëzimi i një propozimi të detajuar për shërbimet e kërkuara, të përgatitur në përputhje me kontratën.
- **Dokumentacioni HSEQ:** Përpara fillimit të çdo aktiviteti në terren, Kontraktori do të jetë përgjegjës për përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve, si p.sh., por jo vetëm:
 - Përgatitja e **Metodologjisë së Punës (MoS – Method of Statement)**, e cila duhet të përgatitet nga operatori ekonomik dhe të miratohet nga AGSco përpara fillimit të punimeve.
 - Përgatitja e **kërkesës për Leje Pune**, e cila duhet të përgatitet nga operatori ekonomik dhe të miratohet nga AGSco përpara fillimit të punimeve.
 - **Lista e produkteve dhe Fletët e të Dhënave të Sigurisë (SDS)** që Kontraktori propozon të përdoren për ekzekutimin e aktiviteteve.
- **Raportimi:**
 - Për çdo ndërhyrje të kryer, Kontraktori duhet të përgatisë një raport të detajuar me prova të aktiviteteve të realizuara.
 - Një **Kërkesë për pagesë**, sipas kontratës, për ndërhyrjet e kryera gjatë muajit, e lidhur me raportet e përgatitura.

Të gjitha shërbimet përfshijnë mjetet, materialet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për të garantuar efektivitetin e trajtimit.

Kontraktori duhet të sigurojë që, kur mbërrin në vendngjarje për largimin e gjarpërinjve, të jetë i pajisur me **PPE të përshtatshme për largimin e gjarpërinjve**.

2.3. Raportet dhe Certifikimet

Pas çdo aktiviteti, Kontraktori do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e një raporti dhe certifikate që përmbajnë, si minimum, informacionin e mëposhtëm:

- Numri progresiv i raportit;

- Data;
- Vendndodhja;
- Gjendja e konstatuar;
- Veprimet e ndërmarra dhe aktivitetet e kryera;
- Personat e përfshirë në shërbim;
- Produktet e përdorura (lloji, marka, sasia, etj.);
- Shënime, Informacione dhe Vërejtje për Klientin, nëse është e nevojshme;
- Nënshkrimi i operatorit që ka kryer shërbimin;
- Nënshkrimi dhe vula e përfaqësuesit të kompanisë.

Gjithashtu, Kontraktori do të ofrojë një **deklaratë të përputhshmërisë ligjore** për shërbimet e ofruara. Raporti i ndërhyrjes dhe certifikatat duhet të dorëzohen tek **AGSco** jo më vonë se **3 ditë pas ndërhyrjes**.

2.4. Aktivizimi i Shërbimit dhe Aksesit në Impiantet e TAP-it

Të gjitha ndërhyrjet do të kërkohen nga **AGSco**, e cila do të aktivizojë Kontraktorin përmes mini-kontratave përkatëse. Aksesit në impiantet e TAP-it do t'i lejohet personelit të Kontraktorit vetëm në praninë e një përfaqësuesi të AGSco, i cili do të ofrojë asistencën dhe mbikëqyrjen e nevojshme.

Kontraktori duhet të:

- Respektojë të gjithë dokumentacionin dhe kërkesat përkatëse HSE.
- Sigurojë që i gjithë personeli të ketë përfunduar me sukses programet e detyrueshme të trajnimit.
- Garantojë që i gjithë personeli është i aftë nga ana shëndetësore për punë, të vërtetuar me një deklaratë mjekësore ose certifikatë të aftësisë për punë.

Urdhrrat e Punës zakonisht do të komunikohen me e-mail nga AGSco. Çdo kërkesë do të specifikojë, si minimum:

- Numrin progresiv të kërkesës.
- Vendndodhjen e saktë ku do të kryhet shërbimi.
- Përshkrimin e shërbimit të kërkuar.
- Çdo dokument referues, nëse është i aplikueshëm.
- Datën e kërkuar për fillimin e shërbimit.
- Datën e kërkuar për përfundimin e shërbimit.
- Emrin e përfaqësuesit të AGSco përgjegjës për këtë shërbim.

Pas marrjes së një **Kërkese për Shërbim**, Kontraktori duhet t'ia paraqesë AGSco-s, brenda një periudhe maksimale prej **pesë (5) ditësh kalendarike** nga data e kërkesës (në çdo periudhë të vitit), një propozim me shkrim që të përfshijë:

- Një përshkrim të shkurtër të aktivitetëve të parashikuara për justifikimin e propozimit.
- Vendndodhjen e shërbimeve.
- Një listë kufizimesh, nëse ka.
- Datat e planifikuara për fillimin dhe përfundimin e shërbimit.

Rrjedha e procesit të punës për ekzekutimin e shërbimeve përshkruhet në **Aneksin 3 (Menaxhimi i dokumentacionit dhe sistemeve)**.

2.5. Takimet e Koordinimit

Kontraktori duhet të marrë pjesë, si minimum çdo dy muaj (përpara kryerjes së një shërbimi), në takimet e mëposhtme të koordinimit:


- Takime koordinimi për planifikim dhe kontroll
- Takime koordinimi për HSE

Takime specifike koordinimi mund të kërkohen nga Kompania, ose nga vetë Kontraktori, në rast nevojë.

3. VENDNDODHJET E SHËRBIMEVE

Aktivitetet do të kryhen në impiantet dhe vendndodhjet përgjatë gjithë gazsjellësit TAP.

Në figurën më poshtë paraqitet itinerari gjeografik i gazsjellësit TAP, ku do të zhvillohen shërbimet.



Coordinates or indications	Site	Region	Type of area	Approx. Area (m ²)
Latitude: 40.791871°	ACS03 - Fier Compressor Station	Fier	Internal	7.000
Longitude: 19.453191°			External	167.000
Latitude: 40.768788°	ABV-31 - Roskovec	Fier	Internal	40
Longitude: 19.694532°			External	1.150
Latitude: 40.582582°	ACS02 - Bilisth metering station	Korca	Internal	536
Longitude: 21.000683°			External	74.464
Latitude: 40.690506°	ABV-24 - Proger	Korca	Internal	40
Longitude: 20.924912°			External	1.100
Latitude: 40.589963°	ABV-25 - Drenove	Korca	Internal	40
Longitude: 20.720251°			External	1.100
Longitude: 40.517906°	ABV-26 - Vithkuq	Korca	Internal	40
Latitude: 20.531710°			External	1.100
Latitude: 40.491486°	ABV-27 - Potom	Berat	Internal	40
Longitude: 20.294908°			External	1.100
Latitude: 40.540174°	ABV-28 - Vendreshe	Berat	Internal	40
Longitude: 20.108435°			External	800
Latitude: 40.675747°	ABV-29 - Vertop	Berat	Internal	40
Longitude: 20.022549°			External	1.100
Latitude: 40.770815°	ABV-30 - Ura Vajugore	Berat	Internal	40
Longitude: 19.855615°			External	1.600

Në **Aneksin 1** paraqiten skemat e një **ABV**, të **ACS02** dhe **ACS03**.

4. KËRKESAT MINIMALE PËR KONTRAKTORIN

Kriteret minimale për kontraktorin janë përcaktuar në Shtojcën 9 të DT.

5. SISTEMET E MENAXHIMIT HSEQ

Shëndeti dhe Siguria e njerëzve, Siguria e infrastrukturës dhe e impianteve, kujdesi për Mjedisin, Cilësia e punimeve dhe Reputacioni janë shtyllat më të rëndësishme të Kompanisë. Kontraktori duhet të garantojë që ekzekutimi i shërbimit do të jetë i orientuar drejt arritjes së standardeve më të larta në përmbushjen e kërkesave HSEQ.

Kontraktori duhet të vendosë si objektiv **“Zero Incidente”** gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës. Kontraktori duhet të përgatisë dokumentet e tij **“Organizimi dhe përgjegjësitë HSEQ”** dhe **“Plani HSEQ”**, specifikisht për këtë kontratë.

5.1. HSE

AGSco-STD-001 “Standardet Minimale HSE për Kontraktorët” do të konsiderohet si pjesë integrale e Fushës së Shërbimit. Ky dokument është paraqitur në **Aneksin 2**.

Kompania do të vërë në dispozicion të gjitha procedurat përkatëse të lidhura me këtë standard për zbatimin e Kontratës pas dhënies së saj.

Në bazë të këtij standardi, Kompania kërkon që Kontraktori të zhvillojë një **Plan HSE të Kontratës**, i cili duhet të identifikojë dhe përshkruajë kontrollet për menaxhimin e risqeve HSE të lidhura me kryerjen e Shërbimeve, përfshirë çdo Shërbim të kryer nga çdo nënkontraktor, dhe duhet të:

- Përkufizojë veprimet që duhen ndërmarrë për të kontrolluar risqet në një nivel të pranueshëm.
- Sigurojë kompetencën, njohuritë dhe aftësitë e gjithë personelit të angazhuar në kryerjen e punës.
- Identifikojë qartë pajisjet që do të përdoren, masat e sigurisë që kërkohen për përdorimin e këtyre pajisjeve dhe PPE që duhet të përdoren gjatë të gjitha fazave të aktiviteteve.
- Sigurojë që personeli të jetë i trajnuar dhe i informuar mbi **Planin dhe Procedurat e Reagimit Emergjent** të Kompanisë dhe Klientit në site, dhe të përgatisë një Plan Efektiv të Reagimit Emergjent.
- Përkufizojë dhe komunikojë përgjegjësitë HSE të personelit.
- Të marrë në konsideratë të gjitha aspektet mjedisore (p.sh. menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e kimikateve/helmeve, etj.) të lidhura me punimet sipas kësaj marrëveshjeje.

Kontraktori do të jetë tërësisht përgjegjës për gjithë personelin që kryen punën dhe duhet të sigurojë që ky personel:

- Të jetë plotësisht i informuar mbi risqet e lidhura me vendin e punës dhe aktivitetin.
- Të ketë marrë trajnim adekuat HSE.
- Të pajiset me PPE përkatëse dhe të dijë t'i përdorë ato.
- Të ketë certifikata të vlefshme dhe të përshtatshme për aftësinë për punë (**Fit-to-Work**), kur është e aplikueshme.
- Të jetë i vetëdijshëm dhe i informuar për evakuimin emergjent, rrugët e daljes, pikat e grumbullimit dhe të gjitha dispozitat e lidhura në të gjitha Impiantet e Kompanisë.

Kontraktori është përgjegjës për ngarkimin e të gjithë dokumentacionit HSE të lidhur me personelin dhe pajisjet e tij në sistemin **AGORA**. (shiko Aneksin nr. 3, bashkelidhur ketyre termave)

Kontraktori duhet të monitorojë **tregues të veçantë të performancës (KPI)** çdo muaj, sipas një modeli dhe periodiciteti që do të bihet dakord.

5.2. Menaxhimi i mbetjeve

Kontraktori është përgjegjës për menaxhimin, transferimin dhe asgjësimin e të gjitha mbetjeve urbane dhe të veçanta, si të rrezikshme ashtu edhe jo të rrezikshme, të prodhuara nga vetë Kontraktori gjatë ekzekutimit të aktiviteteve DDD, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përveç sa përcaktohet në dokumentin e AGSco “Kërkesat minimale HSE për Kontraktorët”, Kontraktori duhet të:

- Transferojë mbetjet e sipërpërmendura, nëse ka, tek transportues të autorizuar, ose në impiante riciklimi apo impiante për trajtimin/asgjësimin e mbetjeve, **përpara përfundimit të çdo aktiviteti të kërkuar**.

- Përballojë kostot që rrjedhin nga menaxhimi dhe asgjësimi korrekt i mbetjeve të gjeneruara nga aktiviteti i tij.
- Plotësojë të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji.
- Kryejë të gjitha komunikimet sipas kërkesave ligjore.

Në fund të ciklit të menaxhimit të mbetjeve, Kontraktori duhet t'i dorëzojë AGSco-s, brenda afateve të përcaktuara nga ligji (**30 ditë kalendarike nga data**), një kopje të dokumentit të dorëzimit të kthyer nga impianti i trajtimit/asgjësimit të mbetjeve, i cili vërteton dorëzimin korrekt të mbetjeve të dala nga aktivitetet në impiantet përkatëse.

AGSco rezervon të drejtën, për vete ose për Klientin, që të verifikojë menaxhimin e mbetjeve të prodhuara nga Kontraktori, duke kërkuar dokumentacion për shembull ose duke kryer auditime.

5.3. Rregullat e Sjelljes brenda Impianteve të AGSco ose të Klientit të AGSco

I gjithë personeli i Kontraktorit duhet të zbatojë rregullat e sjelljes të përcaktuara brenda Impianteve të AGSco dhe të Klientit të AGSco, të cilat përcaktohen përmes planeve, procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve, komunikimeve dhe materialeve informuese.

Nëse ndonjë nga punonjësit e Kontraktorit konstatohet se shkel rregullat e sipërpërmendura, **AGSco** rezervon të drejtën të kërkojë nga Kontraktori zëvendësimin e menjëhershëm të punonjësit.

5.4. Leja e Punës (PTW)

Kontraktori duhet të kryejë Shërbimet në përputhje me proceset e **Lejes së Punës (PTW)** të Kompanisë dhe Klientit. Parimet kryesore të sistemit PTW do të përfshijnë:

- Individët duhet të kryejnë vetëm ato punë për të cilat është konfirmuar se janë kompetentë.
- Shërbimi duhet të kryhet në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë.
- Për të gjitha aktivitetet që do të kryhen duhet të hartohet një **vlerësim risku**.
- Fluksi i procesit dhe numri i hapave të autorizimit duhet të jenë proporcionalë me nivelin e riskut (shëndet dhe siguri) të aktivitetit që do të kryhet.

Procesi PTW do të realizohet duke përdorur mjetin elektronik **MOWO**. Kontraktori është përgjegjës për përgatitjen e PTW-së dhe ngarkimin në sistem të të gjithë dokumentacionit të kërkuar.

Informacion shtesë jepet në **AGSco-STD-001 “Standardet minimale HSE për Kontraktorët” (Aneksi 2)**.

5.5. Auditimet HSE

Menaxheri PICOHS/HSEQ i Kontraktorit duhet të kryejë, si minimum, **1 auditim HSE në vit**. Raportet e auditimit do të diskutohen me Kompaninë në një takim të dedikuar.

Përveç auditimeve të kryera nga Kontraktori, **AGSco** do të kryejë, si minimum, një auditim shtesë HSE për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e Kompanisë, kërkesat e Klientit dhe kërkesat ligjore.

6. DETYRIMET E KONTRATËS

6.1. Detyrimet e Kontraktorit

Kontraktori, përveç detyrimeve të tij të përcaktuara në Marrëveshje, do të ketë detyrimin të:

- **Në përgjithësi:**
 - o Të caktojë Personin/Personat Teknikë të Kontaktit, të cilët do të jenë përgjegjës për koordinimin e Shërbimeve.
 - o Të caktojë një ekip HSEQ kompetent, të kualifikuar dhe të përshtatshëm.
 - o Të caktojë personin përgjegjës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (PICOHS).
 - o Të sigurojë personel kompetent, të kualifikuar, të aftë dhe me përvojë për kryerjen e Shërbimeve.
 - o T'u sigurojë personelit të mirëmbajtjes veshje mbrojtëse dhe pajisje sigurie në përputhje me standardet HSE të Kompanisë.
 - o Të sigurojë që gjithë personeli të kryejë një trajnim hyrës HSE nga Kompania/ Klienti në ambientet e

Kompanisë/ Klientit përpara fillimit të Shërbimeve. Trajnimi hyrës parashikohet të zgjasë maksimumi tre (3) orë, me një përsëritje çdo vit pasues.

- **Për çdo kërkesë për Shërbim:**

- o Të kryejë inspektimin (survey), nëse është e nevojshme, për të sqaruar më mirë Fushën e Shërbimit dhe për të përgatitur një propozim të saktë (kostot e inspektimeve përfshihen në tarifat e njësiteve ose normat njësi të shërbimeve).

- o Të kryejë të gjitha aktivitetet paraprake dhe përfundimtare sipas kërkesave të Klientit (dokumentacion HSE dhe Leje Pune (PTW), përgatitja e propozimit, raportimi, kontabilizimi, etj.). Kostot e këtyre aktiviteteve përfshihen në tarifat e njësiteve ose normat njësi të shërbimeve.

- o Të sigurojë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e Shërbimeve.

- o Të jetë përgjegjës për mobilizimin dhe demobilizimin e personelit, pajisjeve, mjeteve dhe materialeve (dhe materialeve të tepërta) për kryerjen e Shërbimit. Kostot e MOB/DEMOB për inspektimet dhe shërbimet përfshihen në tarifat e njësiteve ose normat njësi të shërbimeve.

- o Të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet e transportit, akomodimit, ushqimit dhe shpenzimeve të tjera shtesë (kostot e këtyre aktiviteteve përfshihen në tarifat e njësiteve ose normat njësi të shërbimeve).

- o Të jetë përgjegjës për ngarkimin, transportin, shkarkimin dhe manipulimin e çdo materiali të nevojshëm për Shërbimin, ose që rezulton nga Shërbimi.

- o Të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve në terren.

- o Të informojë Kompaninë sa më shpejt të jetë e mundur për çdo fakt, ngjarje apo situatë që mund të shkaktojë dëme ndaj Kompanisë duke përfshirë, pa kufizim, çdo ngjarje për të parandaluar, shmangur apo zbutur çdo lëndim të individëve, dëmtim apo humbje të pasurisë.

- o Të sigurojë që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar.

- o Të sigurojë që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me Procedurat e Klientit të Kompanisë.

- o Të sigurojë që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me procedurat HSE të Kompanisë dhe Klientit të Kompanisë.

6.2. Detyrimet e Kompanisë

Kompania, përveç detyrimeve të saj të përcaktuara gjetkë në Marrëveshje, do të:

- Të jetë përgjegjëse për caktimin e Personit/Personave Teknikë të Kontaktit, të cilët do të jenë përgjegjës për koordinimin e Shërbimeve.
- Të rezervojë të drejtën për të modifikuar ose anuluar çdo Shërbim.
- Të rezervojë të drejtën për të inspektuar të gjitha aktivitetet e kryera nga Kontraktori.
- Të rezervojë të drejtën për të pranuar ose refuzuar çdo aktivitet në bazë të cilësisë, duke kërkuar rishikim/ripunim nëse vlerësohet e nevojshme.
- Duke mbajtur të drejtën për të ndaluar çdo punë në terren, Kompania do të informojë menjëherë Kontraktorin për arsyet dhe kohëzgjatjen e pritshme të pezullimit të punës.
- T'i sigurojë Kontraktorit akses në Impiante/Objekte.

6.3. Garancitë dhe Afati i Njoftimit të Defekteve

Çdo urdhër-punë/Shërbim i kryer do të mbulohet nga një "garanci" prej 1 (një) muaji. Gjatë kësaj periudhe (Afati i Njoftimit të Defekteve), në rast se konstatohet ndonjë anomali e lidhur me shërbimet e kryera, AGSCo mund t'i kërkojë Kontraktorit të riparojë anomalitë e konstatuara në kuadër të garancisë (në koston e Kontraktorit).

6.4. Sigurimet

Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë sigurimet e mëposhtme:

- **Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta**, për të mbajtur Kontraktorin të dëmshpërblyer kundrejt çdo humbjeje, dëmi, kostoje, etj., që lidhen me çdo lëndim të çfarëdo personi dhe çdo dëmtim prone, me vlerë prej 100.000 (njëqind mijë) euro.
- **Sigurimi i kontrates** për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

7. ANEKSET

- **Aneksi 1:** Planimetritë e impianteve për ACS02, ACS03 dhe një ABV tipologjike
- **Aneksi 2:** AGSco-STD-001 'Standardet Minimale HSE për Kontraktorët'
- **Aneksi 3:** Menaxhimi i dokumentacionit dhe sistemeve

Shtojca 9

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

